



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Glllogocit
	Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Jeton Qela , ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
	Enis Spahiu , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Razije Murtezaj , Zytare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Vehap Hashani , Zyrtar i Lartë Ligjor, Departamenti i Tatimit në Pronë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Vendim



I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendim 02 Nr.432102-53497 për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore në pronën e paluajtshme për vitin 2024

I miratuar më datë 27.10.2023

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 03.10.2023

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 01.11.2023

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Glllogocit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Glllogocit, me anë të aktit që është subjekt i shqyrtimit, synon caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal i autorizon Komunitat që të mbledhin tatimin në pronat e paluajtshme, të cilat ndodhen brenda kufijve territoriale të saj.
3. Për të konkretizuar konstatimin e mësipërm, si dhe tregues i rëndësishëm për të vlerësuar caktimin e normave tatimore për kategoritë e pronave nga Komuna mbetet neni 9 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe neni 39/A të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ku precizohet qartë normat tatimore, si në vijim:

Neni 9 Normat tatimore

“Kuvendi komunal i çdo komune cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, deri më 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit në përputhje me këtë Ligj.”

Neni 39 /A Shkalla tatimore tranzitore



Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin I të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejnë dispozitat e ligjit bazik.

4. Nëse elaborohet vlerësimi ligjor krahas aktit administrativ komunal, mund të evidentohet se Kuvendi komunal i Glllogocit i ka caktuar normat tatimore për kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike, para afatit kohor të 30 nëntorit. Duke qenë kështu, Komuna ka vepruar në konformitet me konditat ligjore.
5. **Rrjedhimisht, dhe si përfundim i këtij vlerësimi, akti administrativ i Komunës së Glllogocit është në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, U. d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Gillogocit Kryesuesi i KK - Gillogoc Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Date: 31.10.2023 VI- 020-834
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave Shkresë përcjellëse në MFPT	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës		
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse		
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MFPT	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin 02 Nr. 432102-53497 për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024, i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gillogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02 Nr. 432102-53497 për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024

I miratuar më datë: 27.10.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.10.2023



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 432/02-534/27 dt. 27.10.2023

REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës
30.10.2023
-01- 020-677/27



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Neni 9 dhe neni 10 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, dhe neni 36 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 27.10.2023, miratoi këtë:

VENDIM

Për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, dhe paragrafin 2 të neni 10, Kuvendi Komunal i Komunës së Glllogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave-----0.10%
- Për njësitë bujqësore të objekteve-----0.10%
- Për njësitë pyjore të parcelave-----0.10%
- Për njësitë rezidenciale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë rezidenciale të objekteve-----0.10%
- Për njësitë komerciale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë komerciale të objekteve-----0.10%
- Për njësitë industriale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë industriale të objekteve-----0.10%

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë, dhe fillon së zbatuari nga 1 janari 2024.


Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Milaim Hajdari

Arsyctim

Në zbatim të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 2 i nenit 10, Kuvendi Komunal i Komunës së Glllogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave.

Si dhe sipas kërkesës së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për rishqyrtim të ligjshmërisë nr.1919-1/2023 të dt.27.09.2023, me të cilën kërkesë ka kërkuar që të plotësohet ndryshohet vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e Paluajtshme për vitin 2024, nr.02-432-01-43976 të dt.31.08.2023.

